



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.444/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj-Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje(LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesat e subjektit, politik Partia Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, të ushtruara kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje me Anr.444/2025, Anr.445/2025, Anr.448/2025, Anr.460/2025 të datës 07.02.2025, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuar me numër Anr.444/2025, Anr.445/2025, Anr.448/2025, Anr.460/2025 nga subjekti politik, PDK, kundër subjektit politik LVV.

Në ankesën Anr.444/2025, pretendohet se më datë 7 shkurt 2025, në mediat elektronike në Kosovë është shpërndarë një fotografi e disa mbështetësve të Lëvizjes Vetëvendosje, njëri nga të cilët vërehet duke ngritur tre gishta lartë, gjesti i të cilës është simbol ekskluziv serb, i cili në vitet e fundit ka marrë ngjyrimet e forta nacionaliste, pasi u përdor në masë nga forcat paramilitare serbe në luftërat e zhvilluara në Ballkan. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: CD me përmbajtje të videove të edicionit të lajmeve në televizionin Klan Kosovo, e datës 7 shkurt 2025 <https://www.facebook.com/KlanKosovaOfficial> /videos/958683849228346; Fotografia e publikuar në mediat elektronike të Kosovës, ku vërehen mbështetësit e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, duke ngritur tre gishta lartë, simbol ekskluziv serb, e cila është përdorur nga forcat paramilitare serbe në luftërat e zhvilluara në Ballkan.

Në ankesën Anr.445/2025 më datë 7 shkurt 2025, në ora 20:33 mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ish Këshilltar politik i Kryeministrit z. Albin Kurti, z. Shkëlzen Gashi ka publikuar një status në profilin e tij në rrjetin social Facebook, në të cilin shkruan :

"mbeturinat e shik-ut po mundohen me i bindë pjestarët e komunitetit mysliman që me vota për familjen, se e dijnë që shumica dëmuese e pjesëtarëve të komunitetit mysliman nuk e votojnë pdk-në. Qëllimi i këtyre mbeturinave është me e rrëzuar Ivv nën 50% e me e kthyer regjimin e vjetër në pushtet bashkë me listën serbe: 1. Me plaçkitë buxhetin e shtetit; dhe 2. Me e kthyer sërbinë në veri. Më vjen keq, por: NO PASSARAN!", gjuhë e cila përmban nxitje, urrejtje, ofendim, denigrim dhe njëherit shprehë ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese për partitë kundërshtarë të Lëvizjes Vetëvendosje, ku të njëjtëve i referohet si "mbeturina", "me e plaçkitë buxhetin e shtetit", "me e kthyer sërbinë në veri".Parashtruesi I ankesës si Provë ka bashkangjitur: Postimi i publikuar në profilin e z. Shkelzen Gashi në rrjetin social Facebook<,' <https://www.facebook.com/shkelzengashi/posts/pfbid0GqJvzKoU5PV93qqQDVDPZYSK4FEpQ6oSaFzPteGCemSgJdEhDMjReLemthyIFGt9I>;

Në ankesën Anr.448/2025 pretendohet se më datë 06 shkurt 2025, në ora 19:42/h, në profilin e mbështetësit, simpatizantit dhe aktivistët të Lëvizjes Vetëvendosje, me emrin në rrjetin social Facebook "Albin Forca", ka publikuar një video me tekst shoqërues, në të cilën shkruan "Duhet me qenë shumë antishqiptar për me i votu k'ta shkretana". Ky postim deri në momentin e parashtrimit të kësaj ankese vazhdon të jetë aktiv në rrjetin social Facebook. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Postimi i publikuar nga mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje, në profilin me emër Albin Forca, në rrjetin social Facebook; <https://www.facebook.com/61562178526650/videos/603671165864464>;

Në ankesën Anr.460/2025 pretendohet se më datë 06 shkurt 2025, në ora 21:24/h, në profilin e mbështetësit, simpatizantit dhe aktivistët të Lëvizjes Vetëvendosje, me emrin në rrjetin social Facebook "Albin Forca", ka publikuar një video me tekst shoqërues, në të cilën shkruan "A ju kujtohet kur Albin Kurti e mori mikrofonin dhe tha nuk ban me e votu "Zajednicë" asociacionin? Opozitarusët e sotëm e votuan". Ky postim deri në momentin e parashtrimit të kësaj ankese vazhdon të jetë aktiv në rrjetin social Facebook. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Postimi i publikuar nga mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje, në profilin me emër Albin Forca, në rrjetin social Facebook; <https://www.facebook.com/61562178526650/videos/1084776070088669>;

Në përgjigjen për ankesën Anr.444/2025 të paraqitur në PZAP Nga pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e bashkangjitura ankesës në asnjë rrethanë nuk mund të provohet fakti se mbështetësit e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje kanë ngritur 3 gishta lartë e që simbol i nacionalizmit serb. Fotoja e bashkangjitur ankesës është foto e konstruktuar dhe manipuluar nga media Klan Kosova media e cila gjatë gjithë fushatës zgjedhore është angazhuar me zellin më të madh propagandues përmes manipulimeve të tilla për të dëmtuar imazhin e Lëvizjes Vetëvendosje! në opinionin publik. E vërteta është se mërgimtari që shihet në foto ka të ngritur 2 gishta, simbol i paqes dhe demokracisë kudo nëpër botë. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë si provë ka bashkangjitur Provë: Fotoja origjinale pa ndërhyrje nga Klan Kosova ankesa e palës e kundërshtarë është ankesë irrituese e pakuptimtë sepse të njëjtit do të duhej ta dinin se nuk ka mërgimtarë mbështetës të Lëvizjes Vetëvendosje apo cilitdo subjekt politik shqiptar që do të përkrahte nacionalizmin serb përmes në çfarëdo mënyre.

Në përgjigjen për ankesën Anr.445/2025 ashtu siç vërehet edhe nga shkresat e ankesës në fjalë të paraqitura nga pretenduesi, nuk ekziston asnjë fakt i cili z. Gashi do ta ndërlidhte si pjesë të

LVV. Z. Gashi i cili mund të jetë votues i LVV, njëjtë siç mund ta votojë ndonjë subjekt tjetër të caktuar, nuk është Pjesë e LVV dhe rrjedhimisht, nuk do të mund të ndërlidhej thyerja e rregullave zgjedhore nga LVV.Z. Gashi, i njohur për analizat e politikave të ndryshme, qoftë përmes intervistave apo pjesëmarrjes në emisione të ndryshme televizive, qoftë përmes postimeve në Ilogarinë e tij personale në Facebook (publicist, analist, gazetar), njihet si kritik i politikave të caktuara, shumë herë kritik edhe për politikën dhe programin e LVV-së. Me një shikim të thjeshtë në Ilogarinë e tij personale në Facebook, mund të vërehet qëndrimi kritik i z. Gashi ndaj të gjitha subjekteve. Rrjedhimisht, z. Gashi nuk mund të kualifikohet si mbështetës dhe pjesë e LVV, përderisa statusi i tij prej gazetari apo publicisti, jep hapësirë dhe lirinë e kritikës dhe mbështetjes për politikën dhe programet e caktuara politike. Madje në linqet si më poshtë, z. Gashi kritikon edhe LVV-në. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë si provë ka bashkangjitur Fotografi dhe linku me qëndrimet e z. Gashi, ndryshe nga pretendimet e parashtruesit:https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=10164666170768294&id=731278293&mibextid=wwXifr&rdid=ULRD2Rux7ncXXzR1#

https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=10164676605323294&id=731278293&mibextid=wwXifr&rdid=6cMRTVy5B4KE73ot#

<https://vm.tiktok.com/ZMkpg07Y7/>

<https://vm.tiktok.com/ZMkpgTFtX/>

Në përgjigjen për ankesën Anr.448/2025 nga pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e bashkangjitura ankesës në asnjë rrethanë nuk mund të provohet fakti se video me përshkrim si në ankesën e ankuesit është publikuar nga ndonjë mbështetës i LVV-së, kjo për arsye se profili në Facebook është i pa identifikueshëm pa emër dhe mbiemër dhe i njëjti mund të jetë krijuar edhe nga palët kundërshtarë me qëllim që më pas të ankohen në PZAP kundër Lëvizjes Vetëvendosje. Megjithatë PZAP në lidhje me këto postime nga ky profil i rrejshëm Lëvizjes Vetëvendosje i ka shqiptuar gjobë me vendimin Anr.352/2025. Meqenëse LVV nuk e kontrollon menaxhon këtë Ilogari të rrjetit social e ka të mundur ndërmarrjen e masave konkrete për heqjen apo fshirjen e materialeve foto dhe video.

Në përgjigjen në ankesën Anr.460/2025 nga pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e bashkangjitura ankesës në asnjë rrethanë nuk mund të provohet fakti se video me përshkrim si në ankesën e ankuesit është publikuar nga ndonjë mbështetës i LVV-së, kjo për arsye se profili në Facebook është i pa identifikueshëm pa emër dhe mbiemër dhe i njëjti mund të jetë krijuar edhe nga palët kundërshtarë me qëllim që më pas të ankohen në PZAP kundër Lëvizjes Vetëvendosje. Meqenëse LVV nuk e kontrollon menaxhon këtë Ilogari të rrjetit social nuk e ka të mundur ndërmarrjen e masave konkrete për heqjen apo fshirjen e materialeve foto dhe video. Përndryshe nga shkrimi i bashkangjitur me fotografi nuk mund të konstatohet përdorim i gjuhës ofenduese sepse nuk i referohet palës kundërshtarë.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.444/2025, A.nr.445/2025, A.nr.448/2025 dhe Anr.460/2025 të paraqitura me datë 07.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj

procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.444/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik PDK kundër subjektit LVV, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, vëren se ankesat janë të pa bazuara.

Për faktin se pas shikimit të shkresave të ofruara si prova materiale nga ankuesi, ku sipas ankuesit shihet një foto e disa mbështetësve të Lëvizjes Vetëvendosje, njëri nga të cilët vërehet duke ngritur tre gishta lartë, gjesti i të cilës është simbol ekskluziv serb, i cili në vitet e fundit ka marrë ngjyrimet e forta nacionaliste, pasi u përdor në masë nga forcat paramilitare serbe në luftërat e zhvilluara në Ballkan. Mirëpo sipas vlerësimit të panelit i njëjti pretendim është i pa bazuar, ngase pas shikimit të fotos të bashkangjitur si provë përgjigjes në ankesë, vërehet në foto origjinal se simpatizantët e LVV-së i ka ngritur dy gishta e jo tre siç pretendon ankuesi.

Kurse lidhur me pretendimet tjera nga ankesat se ish Këshilltar politik i Kryeministrit z. Albin Kurti, z. Shkëlzen Gashi ka publikuar një status në profilin e tij në rrjetin social Facebook, në të cilin shkruan "mbeturinat e shik-ut Po mundohen me i bindë pjesëtarët e komunitetit mysliman që me vota për familjen, se e dijnë që shumica dërmuese e pjesëtarëve të komunitetit mysliman nuk e votojnë pdk-në. Qëllimi i këtyre mbeturinave është me e rrëzuar Ivv nën 50% e me e kthyer regjimin e vjetër në pushtet bashkë me listën serbe: 1. Me plaçkitë buxhetin e shtetit; dhe 2. Me e kthyer serbinë në veri. Më vjen keq, por: No pasaran!, gjuhë e cila përmban nxitje, urrejtje, ofendim, denigrim dhe njëherit shprehë ngjyrimet përçmuese ose nënvlerësuese për partitë kundërshtarë të Lëvizjes Vetëvendosje, ku të njëjtëve i referohet si "mbeturina", "me e plaçkitë buxhetin e shtetit", "me e kthyer serbinë në veri. Gjithashtu edhe pretendimi se simpatizantit dhe aktivistët të Lëvizjes Vetëvendosje, me emrin në rrjetin social Facebook "Albin Forca", ka publikuar një video me tekst shoqëruar, në të cilën shkruan "Duhet me qenë shumë antishqiptar për me i votu k'ta shkretana". Ky postim deri në momentin e parashtrimit të kësaj ankese vazhdon të jetë aktiv në rrjetin social Facebook, simpatizantit dhe aktivistët të Lëvizjes Vetëvendosje, me emrin në rrjetin social Facebook "Albin Forca", ka publikuar një video me tekst shoqëruar, në të cilën shkruan "A ju kujtohet kur Albin Kurti e mori mikrofonin dhe tha nuk ban me e votu "Zajednicë" asociacionin? Opozitarusët e sotëm e votuan.

Duke i vlerësuar këto deklaratime të mbështetësve të LVV-së, Paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese ofenduese dhe të urrejtjes në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Fjalimet e tilla të përdorura nga mbështetësit e LVV-së konsiderohen se hyjnë në diskursin e fushatës zgjedhore, dhe nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon një person tjetër për të kryer një akt dhune kundër personave të tjerë ose pasurisë, vlerësim, përkatësisht, ky i konfirmuar edhe me aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Prandaj paneli vlerëson se deklaratimet e lartcekura nga ana e mbështetësve të LVV-së, nuk konsiderohet se është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, e LZP-së, në të cilin nen përcaktohet se "*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person*

tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nënin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.444/2025, datë 10.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.